

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR
“AIR LOUNGE 3“ SHPK

Në Tiranë, sot më datë 17.05.2022, I poshtëshënuari :

Almiro Gurakuqi, i datelindjes 27.12.1972, shtetas Shqiptar ,mbajtes i ID Nr. H21227034V me cilësinë e “ortakut themelues”

Arbian Safa i datelindjes 06.03.1985, shtetas Shqiptar ,mbajtes i ID Nr. I50306087D me cilësinë e “ortakut themelues”

Tedi Mula i datelindjes 15.11.1995, shtetas Shqiptar ,mbajtes i Pasaportes Nr. J51115073G

me cilësinë e “ortakeve themelues” deklarojme se me vullnet të lirë të plotë, mbeshtetur në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqërítë tregtare” i ndryshuar, ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar, krijojmë shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, **“AIR LOUNGE 3“ shpk**

Neni 1
Emri, Forma

Shoqëria do të ketë emrin **“AIR LOUNGE 3“ shpk** , dhe formë ligjore:
“Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

Neni 2
Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik, pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Neni 3
Selia

Shoqëria e ka seline në adresë:
Ndertesa Nr 5, Rruga Nacionale Kukes Peshkopi, Km 3, Shtiqen, Kukes Albania

Neni 4
Objekti i veprimtarisë

Kompania do të kryejë aktivitetin si më poshtë me kete objekt:

1. Bar – Kafe, Restorant

Neni 5
Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj pa afat.

Neni 6
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 lekë.

Kapitali i mesperm eshte nënshkruar nga “ortaket “e shoqerise :

Almiro Gurakuqi, zoterues i 1 kuote me vlore te per gjithshme 25.000 Leke, qe perben 25 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Arbian Safa zoterues i 1 kuote me vlore te per gjithshme 50.000 Leke, qe perben 50 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Tedi Mula,, zoterues i 1 kuote me vlore te per gjithshme 25.000 Leke qe perben 25 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Kontributi i ortakeve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortaket per gjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise;

Neni 7
Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme vetëm me rrugë trashëgimie. Transferimi i kuotave si ortakëve të shoqërisë ashtu edhe për personat e tjere jashtë shoqërisë është i kushtëzuar me miratimin e Asamblesë.

Neni 8
Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendor në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;

- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gi) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmérinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmérinë, apo në bazë të rr Ethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9
Administratori

Administrator i shoqërisë eshtë:

- Tedi Mula, i datelindjes 15.11.1995, shtetas Shqiptar ,mbajtes i Pasaportes Nr. J51115073G, emëruar ne këtë detyrë për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtitje.

Neni 10
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislativit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republiken e Shqipërisë.

Neni 11
Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 kopje, në gjuhën shqipe, me përbajtje dhe vlera te njëjta juridike.

Akti i mësiperm pasi miratohet në parim dhe nen per nen nga Ortaket themelues të shoqërisë tregtare "**AIR LOUNGE 3**" shpk , nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vodosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinale.

ORTAKET THEMELUES

Almire Gurakuqi,


Arbian Safa


Tedi MULA
